



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.12

Prishtinë, më 22.04.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu.

Mungoi: Jelena Bontiç dhe Mufera Sinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Petrit Hysaj-OSBE, Ukë Gashi-ZPRK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.04.2015;
3. Diskutim lidhur me formimin e grupit punues për Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore.
4. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.04.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 15.04.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me formimin e grupit punues për Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore

Nait Hasani, tha se projektligji për Provimin e Maturës Shtetërore është proceduar për lexim të parë në Seancë plenare. GIZ-i ka dërguar disa komete lidhur me këtë projektligj, në çështjet që ndërlidhen me prapun e kalueshmërisë, me ç'rast ata kërkojnë që të mbetet pragu, në mënyrë që studentët që e kalojnë 50% të provimit të maturës t'iu lejohet të konkurrojnë në Fakultet, ndërsa ata që nuk e arrijnë 50% të pajisen me diplomë por të mos kenë të drejtë të konkurrojnë në Fakultet.

Bekim Haxhiu, tha se do ti trajtojmë të gjitha vërejtjet që vijnë në Komision për këtë projektligj, duhet të ftohen edhe përfaqësuesit nga Ministria dhe të japin sqarime lidhur me heqjen e pragut të kalueshmërisë.

Teuta Haxhiu, tha se lidhur me këtë projektligj kemi diskutuar edhe në legjislaturën kaluar, ne do ti shqyrtojmë të gjitha shqetësimet që adresohen për këtë projektligj. Ajo theksoi se nëse nuk hiqet pragu i kalueshmërisë, prapë do të ketë parregullsi duke u nisur nga kryetarët e komunave, shkollat etj. Disa prej Institucioneve janë të interesuara që të ketë prag të kalueshmërisë dhe prap ka konflikte interesi në mes të Institucioneve private dhe publike.

Salih Morina, tha se në seancën e fundit kemi kërkuar të futet si pikë e veçantë e rendit të ditës me qëllim që ti zëmë afatet e provimit por pasi që deri më 7 maj nuk ka seancë, propozoi që të ftohet Ministri dhe të diskutohet se a mundemi që këtë vit të zëmë afatin e provimit.

Shukrije Bytyqi, tha se do të ishte mirë që grupi punues dhe organizatat që janë të interesuara të marrin pjesë të fillojmë me punën dhe ti shqyrtojmë edhe qëndrimet e GIZ-it. Lidhur me parregullsitë gjatë provimit të maturës, ajo tha se këto tejkalohen kur provimi i maturës të digjitalizohet.

Nait Hasani, tha se të gjitha shkresat që ka pranuar janë që të ketë prag të kalueshmërisë për studentët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet, secili që merr diplomë të ketë një certifikatë nëse i lejohet apo jo të vazhdojë studimet, duhet të diskutohet edhe çështja e pagesës së provimit të maturës.

Bekim Haxhiu, tha se sipas GIZ-it të gjithë ata që i nënshtrohen testit të arritshmërisë të marrin diplomën e shkollës së mesme me pikët të cilat i kanë marrë dhe ata të cilët e kalojnë mbi 50% testin të kenë një certifikatë shtesë e cila konfirmon se i plotësojnë kriteret për të konkurruar në Fakultet.

Shpejtim Bulliqi, tha se duhet të shikojmë situatën tonë dhe të bëjmë ligjin për kushtet tona sepse e dimë se shumë eksperimente na janë imponuar në arsim dhe shumë prej tyre kanë dështuar, prandaj duhet ti marrim vërejtjet dhe sugjerimet që janë të arsyeshme dhe që mund të ndikojnë pozitivisht. Ai theksoi se nuk ka nevojë të lëshohet certifikata por të rregullohet me ligj që të gjithë ata kalojnë testin mbi 50% t'u mundësohet që të konkurrojnë në Fakultet.

Nait Hasani, tha se pas leximit të parë të Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore, Komisioni do të organizoj një dëgjim publik lidhur me këtë projektligj, ne të cilin do të ftohet të gjitha grupet e interesit dhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit.

4. Të ndryshme

Nait Hasani, tha se Instituti Albanologjik ka kërkuar që të hartohet një Ligj për mbrojtjen e gjuhës standarde shqipe dhe lidhur me këtë është përgatitur një draft, i cili duhet të shikohet dhe krahasohet me ligjet e rajonit se si është e rregulluar kjo çështje.

Në vazhdim tha se Instituti ISPE ka sjell një dokument për shkeljet që janë bërë nga Agjencioni i Akreditimit, dhe ka ankesa edhe nga bartës të tjerë lidhur me procesin e akreditimit.

Teuta Haxhiu, theksoi se ka vendime të ekspertëve të cilët rekomandojnë mos akreditim të një programi, ndërsa Agjencioni e akrediton. Ajo tha se ka material të shumë institucioneve, për parregullsitë që bëhen në Agjencion, dhe kërkoi që anëtarët e AKA-se që janë në hetime është mirë të kërkojmë shkarkimin e tyre. Gjatë monitorimit të Ligjit të Arsimit të Lartë, Basri Muja atëherë si drejtor i Agjencionit të Akreditimit, ka qenë këshilltar i jashtëm i ministrit të arsimit, përderisa ai është drejtor në AKA si Institucion i pavarur nuk duhet të jete edhe Këshilltar i ministrit. Në vazhdim tha se për kolegjin AAB, as ministri nuk ka ndërmarre diçka për ti përmirësuar adresat elektronike apo reklamat e ndryshme

Bekim Haxhiu, tha se e dimë që këto kolegje kanë një nivel dhe cilësi jo të mirë në arsim, disa prej tyre i kontaktojnë ekspertët e jashtëm dhe mundohen të ndikojnë në raportet e tyre. Ai theksoi se e kam pyetur edhe Znj. Zhushi se si mund të akreditohet një drejtim në institucion privat kur në sektorin publik nuk akreditohet dhe të njëjtin drejtim e akrediton me gjysmën e stafit të sektorit publik.

Shukrije Bytyqi, tha se duhet të kërkojmë raport edhe nga drejtorja e inspektoratit të Ministrisë së Arsimit sepse ka dëshmi që institucionet private kanë pranuar student pa përfundimin e shkollës së mesme dhe pa kaluar testin e maturës. Sa i përket mësimdhënësve në kolegjet private tha se ka mësimdhënës bartës të lendeve në kolegjet private me studime bachelor.

Nait Hasani, tha se Ministri ka emëruar dy anëtarë të Këshillit të Agjencionit të Akreditimit, Blerim Rexha dhe Qendrim Gashi.

Ismajl Kurteshi, tha se ne si Komision duhet të dalim zyrtarisht të kërkojmë heqjen e këtyre mbishkrimeve të rrejshme dhe të kërkojmë përgjegjësi prej të gjitha atyre kolegjeve private. Të kërkohej përgjegjësi nga të gjitha ato kolegje që kanë regjistruar student pa provim të maturës. Në vazhdim tha se për Agjencionin e Akreditimit, përderisa ata janë në hetime nuk mund të

kërkojmë shkarkim por mund të kërkojmë ngrirje të marrëdhënies së punës së atyre që janë nën hetime.

Nait Hasani, në vazhdim njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me një shkresë të bërë nga një student për pretendimet e tij për padrejtësi gjatë vlerësimit të testit pranues për studime Master. Lidhur me kërkesën për shëndrrimin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në Universitet, tha se kërkesën e kemi dërguar te ministri dhe është dhënë shpjegimi në Kuvend.

Bekim Haxhiu, tha se përpara se të japim mbështetjen e themelimit të çdo universiteti të ri në shtetin e Kosovës ne do të duhet të kemi se paku disa të dhëna bazike, se sa është numri i personelit akademik, çfarë stafi kanë dhe sa kanë hapësirë për mbarëvajtje të mësimi. Ai theksoi se është një kërkesë për themelimin e Universitetit të Shkencave Mjekësore i nënshkruar prej 256 mësimitdhënësve të Fakultetit të Mjekësisë, ky Universitet i plotëson kriteret ligjore që i ka 5 drejtime bazike dhe e ka numrin e studentet dhe e ka hapësirën. Në legjislacionin aktual në fuqi ligji për arsimin e lartë, nën 3 parasheh që në Universitetin e Prishtinës të mbahen studime 3 dhe 4 vjeçare dhe nuk parashihen studimet 5 vjeçare dhe në bisedë me ministrin paraprak kam parashtruar çështjen se këta student që prej pas luftës a i kanë përfunduar studimet sipas ligjit. Në vazhdim tha se statuti i Universitetit të Prishtinës çdo herë është dashtë të adaptohet apo të shtohet për Fakultetin e Mjekësisë, për arsye se dallon niveli i studimeve dhe forma e studimeve nga Fakultetet tjera. Do të duhet që ta mbështesim edhe këtë të Ferizajt por kur të kemi të dhënat e sakta, gjithashtu duhet të kërkojmë nga ministri se si e ka planifikuar për të ardhmen.

Nait Hasani, tha se sa i përket themelimit të Universitetit të Shkencave Mjekësore mund ta trajtojmë si Komision dhe ta mbështesim një kërkesë të tillë. Në vijim ceku edhe çështjet e tri shkolla të mesme të pa përfunduar, një në Ferizaj, një në Podujevë dhe në Prizren të cilat për shkak të keqpërdorimeve nuk janë përfunduar, dhe janë me shume se 1500 nxënës që bëjnë nga 2 apo 3 ndërrime, si Komision duhet të kërkojmë nga Ministria gjatë rishikimit të buxhetit të zgjidhen këto çështje, si dhe çështja e katër shkollave që ende janë në baraka. Gjithashtu ai përmendi kërkesën e parashtruar nga Zijadin Gashi, kryetar i Këshillit të iniciativës të të punësuarve të arsimit shqiptar 90-99, që të miratohet ligji për njohjen e stazhit të punës së kësaj kategorie.

Ismajl Kurteshi, tha se përmes ligjit për buxhet është aprovuar që të gjithë ata që dalin në pension tu paguhet përvoja mirëpo mësimitdhënësit thonë se nuk është duke u zbatuar kjo.

Nait Hasani, lidhur me çështjen e diplomave false të lëshuara nga Fakulteti i Edukimit në Gjakovë, kemi një aktvendim të parashkrimit të lëndës nga ana e Gjykatës në Gjakovë. Duhet kërkuar nga Ministri i Drejtësisë që të ndërmerr masat konform kompetencave që ka për zgjedhjen e çështjes pasi që kemi të bëjmë me neglizhencë të Gjykatës..

Shpejtim Bulliqi, tha se duhet të gjendet forma për të riaktivizuar lëndën dhe në emër të Komisionit të kërkohet nga organet kompetente që të ndërmerren masat për të rishqyrtuar lëndën.

Nait Hasani, tha se projektligji për Trashëgimin Kulturore u është shpërndarë deputetëve, i njëjti do të shqyrtohet në parim në mbledhjen e radhës së Komisionit. Sa i përket anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, propozoi që procesi i emërimit të anëtarëve të këtij Këshilli të bëhet me Ligjin e ri, ndërsa ta tërhiqet rekomandimi i Komisionit.

Salih Morina, tha se është brengosësh çështja se ka emra që i kemi votuar dhe nuk e dimë se kush janë, ai theksoi se do të ishte më mirë që secili nga anëtarët të vie në intervistë sepse ky Këshill është jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse shumë investime kapitale ne këtë fushë varen nga puna e Këshillit.

Shukrije Bytyqi, tha se është diskutuar që ka zbrastësira ligjore dhe që ky Komision është i vonuar, ndërsa për shkak të rëndësisë janë përshpejtuar procedurat për përzgjedhjen e tyre dhe tani nuk është e arsyeshme të punojmë kundër vetës përderisa e kemi përfunduar procesin e përzgjedhjes.

Teuta Haxhiu, tha se ne si Komision e kemi bërë vlerësimin tonë për kandidatët dhe nuk e shoh të arsyeshme që i gjithë ai proces të kthehet prapa.

Bekim Haxhiu, theksoi se edhe me projektligjin e propozuar është ruajtur dualizmi në mes të Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshillit të Kosovës për Trashëgimisë Kulturore, ky dualizëm duhet të eliminohet. Në vazhdim tha se në projektligjin e ri propozimi i anëtarëve të Këshillit është ruajtur në të njëjtën formë dhe nëse nuk precizohet mënyra e zgjedhjes së anëtarëve dhe mandati i tyre, do të ketë hapësirë për parregullsi.

Salih Morina, tha se ky Këshill dhe Bordet tjera që financohen nga Kuvendi duhet të zgjidhet nga i njëjti organ, mirëpo me projektligjin e ri prapë propozimet i bënë Ministria dhe kjo çështje duhet të diskutohet edhe një herë dhe të rregullohet.

Shpejtim Bulliqi, tha se do të ishte mirë që në seancë të gjithë të kemi një qëndrim si Komision dhe mos ta ndërrojmë qëndrim në momentin e fundit. Ai propozoi që anëtarët e përzgjedhur të votohen në Kuvend dhe të bëhet funksional ky Këshill.

Ismajl Kurteshi, tha se si Komision kemi kërkuar dokumentacionin e kandidatëve dhe bazuar në dokumentacion jemi përcaktuar për kandidatët që kemi menduar se janë adekuat dhe ne duhet ti përkrahim ata edhe nëse mandati i tyre zgjat vetëm 3 muaj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Nait Hasani